

E DREJTA PËR INFORMIM



Rekomandime për zbatimin e Programit të Transparencës së Universiteteve Publike

Nisur nga rëndësia që paraqet sektori i arsimit, Zyra e Komisionerit ka vendosur në fokus të punës për vitin 2023, monitorimin e transparencës proaktive në sektorin e arsimit dhe veçanërisht në universitetet publike.

Përpos parashikimeve në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" transparencja e institucioneve të arsimit të lartë ushtrohet edhe në respektim të detyrimeve ligjore të parashikuara në legjisllacionin e posaçëm për arsimin e lartë, veçanërisht në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin nr. 781, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave "Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë".

Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit ka ndërmarrë hapa për monitorimin e transparencës proaktive në këtë sektor, duke e nisur fillimisht me universitetet publike. Konkretisht gjatë muajit shkurt janë monitoruar 12 Universitete Publike për nivelin e zbatimit të programit të transparencës duke përfshirë në të, të gjithë kategoritë e informacionit që prodhohet nga këto autoritete publike.

Pas përfundimit të monitorimit, Zyra e Komisionerit ka miratuar 12 Rekomandime për publikimin e informacionit në Programin e Transparencës së institucioneve të arsimit të lartë të cilat mund ti konsultoni në faqen zyrtare www.idp.al

PËRMBLEDHJE MUJORE E VENDIMEVE dhe REKOMANDIMEVE

Vendim Nr. 4 -Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Rekomandim Nr. 5 - Universiteti i Sporteve të Tiranës

Rekomandim Nr. 6 - Universiteti Bujqësor i Tiranës

Rekomandim Nr. 7 - Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Rekomandim Nr. 8 - Universiteti i Arteve

Rekomandim Nr. 9 - Universiteti i Mjekësisë Tiranë

Rekomandim Nr. 10 - Universiteti "Fan S. Noli" Korçë

Rekomandim Nr. 11 - Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan

Rekomandim Nr. 12 - Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

Rekomandim Nr. 13 - Universiteti "Eqerem Çabej" Gjirokastrë

Rekomandim Nr. 14 - Universiteti i Tiranës

Rekomandim Nr. 15 - Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër

Rekomandim Nr. 16 - Universiteti Politeknik i Tiranës

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit shkurt 2023

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit shkurt 2023, ka dhënë 1 vendim urdhërimi në zbatim të ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit dhe 12 rekomandime.

Me anë të vendimit nr. 4 datë 21.02.2023, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Komisioni i Pavarur i Kualifikimit", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare". Kërkuesi ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si më poshtë:

- *Sa gjyqtarë dhe prokurorë janë shkarkuar në periudhën Janar 2021 – Tetor 2022, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim, "KPK") apo vendim të formës së prerë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit? Cilat janë pozicionet që ata kanë mbajtur në sistemin gjyqësor dhe të prokurorisë?*
- *Sa gjyqtarë dhe prokurorë janë dorëhequr brenda të njëjtës periudhe? Cilat janë pozicionet që ata kanë mbajtur në sistemin gjyqësor dhe të prokurorisë?*
- *A ka pasur raste kur Autoriteti Publik apo anëtarë të tij kanë referuar apo kallëzuar pranë Prokurorisë së Posaçme apo ato të Juridiksionit të Përgjithshëm, fakte që janë zbuluar gjatë procesit të rivlerësimit që përbëjnë vepra penale që ndiqen kryesisht, në zbatim të nenit 281, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale? Komiteti Shqiptar i Helsinkit kërkon të njihet me kopje të dokumentacionit, me anë të të cilit është bërë ky referim.*
- *A ka patur raste kur prokuroritë në fjalë janë vendosur në lëvizje me inisiativë (ex officio), në kushtet kur procesi i vettingut ka karakter publik? Një kopje të dokumentacionit (nëse disponohet) ku ndërmerret nisma nga prokuroritë në fjalë, në korrespondencën që mund të kenë patur me ju, për këtë periudhë?*
- *Në kuadër të pikave 3 dhe 4 si më sipër, a ju është komunikuar nga këto prokurori nevoja për dokumentacion shtesë lidhur me këto subjekte apo çdo kërkesë apo komunikim tjetër zyrtar prej tyre në funksion të mbarëvajtjes së hetimeve (Komiteti Shqiptar i Helsinkit kërkon të njihet me kopjen e dokumentacionit nëse dispononi)?*

Autoriteti Publik, i ka kthyer përgjigje kërkuarit duke i vendosur në dispozicion informacionin për pikën 1 dhe 2 të kërkesës. Për pikën 3, 4 dhe 5 është refuzuar dhënia e dokumentacionit përkatës të kërkuar për informacion me arsyetimin se kjo e drejtë është e kufizuar sipas parashikimit të nenit 17, pika 2/b e ligjit nr. 19/2014 "Për të drejtën e informimit".

Pas përgjigjes së Autoritetit Publik, kërkuarja me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, Zyra e Komisionerit ftoi palët në një seancë dëgjimore, me prezencën e përfaqësuesëve të ankuesit dhe Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i ankuesit rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë, me pretendimin se, vetë Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur në dispozicion një informacion mbi hetimet ndaj subjekteve të rivlerësimit. Ndërkohë, përfaqësuesit e Autoritetit Publik u pyetën nëse dokumentacioni i kërkuar është i klasifikuar sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", i ndryshuar, apo sipas legjislacionit të posaçëm penal.

Ata u shprehën se nuk e kishin konsultuar fizikisht dokumentacionin e kërkuar. Në këto kushte, kërkuar kohë për t'u shprehur për këtë çështje si dhe për të vlerësuar pretendimin e ngritur nga ankuesi në lidhje me vënien në dispozicion të informacionit nga SPAK. Gjithashtu, rikonfirmuan qëndrimin në lidhje me pikën 3, 4 dhe 5.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit. Në qëndrimin e Autoritetit Publik, Komisioneri konstaton se, kufizimi i informacionit është bërë në referim të shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 17 të LDI, pa marrë parasysh pikën 6 të këtij neni në të cilën citohet se:

"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë jesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".

Nga dokumentacioni i administruar, nuk rezulton se Autoriteti Publik të ketë bërë një vlerësim të dokumentacionit të kërkuar, por është mjaftuar vetëm me vënien në dispozicion të informacionit statistikor, qëndrim ky në kundërshtim me dispozitën e sipërcituar. Komisioneri thekson se, Autoriteti Publik bazuar në nenin 17 të LDI, ka detyrimin që përveçse të garantojë të drejtën e informimit, të mbrojë të dhënat personale, sekretin tregtar etj. Por, në çdo rast, ekzistenca e një procedimi penal, nuk përbën a priori, pengesë për dhënien e informacionit.

Në rastin konkret, objekt ankese, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se për këto raste Autoriteti Publik ka depozituar kallëzim në SPAK, ai në asnjë moment gjatë hetimit administrativ, nuk provoi se publikimi i këtij informacioni do të cenonte hetimin penal të nisur nga ky i fundit.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur organi hetimor nuk është shprehur për sekret hetimor të rastit konkret dhe Autoriteti Publik pranon se e disponon dokumentacionin, objekt ankese, ai rrjedhimisht përmbush kriteret e pikës 2, të nenit 2 të LDI, në të cilën parashikohet se: "Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik".

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi, urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion. Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit/ankuesit dokumentacionin e kërkuar në formatin e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.

Ambasadori i Prezencës së OSBE në Shqipëri viziton Zyrën e Komisionerit

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, priti në një takim Ambasadorin z. Guido De Sanctis, Kryetar i Prezencës në Shqipëri të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).



Komisioneri shprehu falënderimin për kontributin dhe mbështetjen e dhënë ndër vite nga OSBE për Zyrën e Komisionerit, si dhe për projektet e frytshme të përbashkëta të zhvilluara për të dy fushat e përgjegjesisë institucionale.

Gjatë takimit Ambasadori De Sanctis u njoh me rolin, funksionet dhe veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit, si edhe me procesin e harmonizimit të kuadrit rregullator kombëtar të mbrojtjes së të dhënave personale me acquis të BE, apo dhe atë për përmirësimin e ligjit për të drejtën e informimit.

Palët diskutuan dhe u dakordësuan për të vijuar këtë bashkëpunim në funksion të njohjes dhe ndërgjegjësimit për ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore nga qytetarët.


Garantimi i të drejtave të qytetarëve, standarde bashkëkohore në zbatimin e kuadrit rregullator në Shqipëri dhe Kosovë

Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Kosovës (AIP), u zhvillua takimi i dytë me pjesëmarrjen e stafeve përkatës, që kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit profesional, shkëmbimin/diskutimin e rasteve nga praktika administrative, si dhe planifikimin e nismave për të ardhmen.


Aktiviteti u mbajt përgjatë dy ditëve, ku sipas agjendës u prezantua kuadri rregullator dhe veprimtaria e AIP, si dhe u trajtuan detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përbërëse të autoritetit të Kosovës. Gjithashtu, u vijua me shqyrtimin e rasteve praktike për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Për këtë, u ra dakord që të intensifikohet bashkëpunimi, edhe në kontekstin e zhvillimit të hetimeve të përbashkëta. Gjatë takimit u vlerësua kontributi i Zyrës së Komisionerit për anëtarësimin e AIP në Konferencën Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC). Njëkohësisht, u diskutua për harmonizimin e përpjekjeve për njohjen sa më të gjerë të autoritetit të Kosovës në kuadër të organizmave ndërkombëtare në të dy këto fusha.




Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



[idp.albania](https://www.instagram.com/idp.albania)



[IDP Albania](https://twitter.com/IDPAlbania)



[Komisioneri KDIMDP](https://www.youtube.com/KomisioneriKDIMDP)